

UDHËZIMET ME SHKRIM












ADR-5.4.3

Veprimet në rast aksidenti apo emergjence

Në rast aksidenti apo emergjence që mund të shfaqen apo ndodhin gjatë transportimit, anëtarët e ekuipazhit të automjetit do të ndërmarrin veprimet në vijim ku është sigurt dhe praktike të vepruara ashtu:











- Të aplikojnë sistemin e frenimit, ndaljen e motorit dhe izolimin e baterisë duke aktivizuar ndërprerësin kryesor (master) ku është në dispozicion;
- Shmangien e burimeve të ndezjes, në veçanti, mos pi duhan apo ndez ndonjë pajisje elektrike;
- Informon shërbimet adekuate të emergjencës, duke dhënë sa më shumë informata që të është e mundshme rreth incidentit apo aksidentit dhe materieve të përfshira;
- Veshjen e jelekut paralajmërues dhe vendosjen e shenjave paralajmëruese që qëndrojnë si është e përshtatshme;
- Mbjaj dokumentet e transportit të gatshme për disponim nga ana e atyre të reagimit me të arritur;
- Mos ecë nëpër të apo të prekësh materiet e derdhura dhe shmangu inhalimin e gazrave, tymit, pluhurit dhe avujve duke qëndruar në pjesën e kundërt të erës;
- Kur është e përshtatshme dhe e sigurt për të vepruar, përdor aparatet për fikjen e zjarreve për të fikur zjarret e vogla/fillestare në goma, frena dhe kompartamentin e motorit;
- Zjarret në kompartamentet e ngarkesës nuk duhet të preken nga anëtarët e ekuipazhit të automjetit;
- Kur është e përshtatshme dhe e sigurt për të vepruar, përdor pajisjen në kabinë për të parandaluar rrjedhjet në mjediset ujore apo sistemet e kanalizimit dhe për të frenuar (përmbajtur) rrjedhjet.
- Lëvizë larg nga afërsia e aksidentit apo emergjencës, këshillo personat tjerë për tu larguar dhe përmbaju këshillave të shërbimeve të emergjencës;
- Largo çdo rrobë të kontaminuar dhe pajisjet për mbrojtje të kontaminuara të përdorura dhe lirohu nga ajo në mënyrë të sigurt.

Udhëzime shtesë për anëtarët e ekipazhit të automjetit mbi karakteristikat e rrezikut të mallrave të rrezikshme dhe mbi veprimet që iu nënshtrohen rrethanave që mbizotërojnë

Etiketat dhe shenjat e rrezikshme	Karakteristikat e rrezikut	Udhëzimet shtesë
(1)	(2)	(3)
<p>Substancat dhe artikujt Eksplodues</p> <p>1</p>  <p>1.5</p>  <p>1.6</p>	<p>Mund të ketë një gamë të vetive dhe efekteve të tilla si detonim masiv; shkaktimi i çarjeve; fluks intensivë i zjarrit/ngrohjes; formimi i dritës së shkëlqyeshme, zhurmës së madhe dhe tymit. E ndjeshme ndaj dridhjeve dhe/ose goditjeve dhe/ose nxehtësisë.</p>	<p>Strehohu mirëpo qëndro larg dritareve.</p>
<p>Substancat dhe artikujt Eksplodues</p> <p>1.4</p> 	<p>Rrezik i vogël nga eksplodimi dhe zjarri.</p>	<p>Strehohu.</p>
<p>Gazrat e ndezshme</p> <p>2.1</p>  	<p>Rrezik nga ndezja. Rrezik nga eksplodimi. Mund të jetë nën shtypje (presion). Rrezik nga ngufatja. Mund të shkakton djegie dhe/ose morth (ngrirje). Përbajtet mund të shpërthejnë kur të ngrohen.</p>	<p>Strehohu. Qëndro larg nga zonat e ulëta.</p>
<p>Gazrat e pandezshme, jo toksike</p> <p>2.2</p>  	<p>Rrezik nga ngufatja. Mund të jetë nën shtypje (presion). Mund të shkakton morth (ngrirje). Përbajtet mund të shpërthejnë kur të ngrohen.</p>	<p>Strehohu. Qëndro larg nga zonat e ulëta.</p>
<p>Gazrat toksik</p> <p>2.3</p> 	<p>Rrezik nga helmimi. Mund të jetë nën shtypje (presion). Mund të shkakton djegie dhe/ose morth (ngrirje). Përbajtet mund të shpërthejnë kur të ngrohen.</p>	<p>Përdor maskën emergjente e shpëtimit. Strehohu. Qëndro larg nga zonat e ulëta.</p>
<p>Materialet e ndezshme të lëngëta</p> <p>3</p>  	<p>Rrezik nga ndezja. Rrezik nga eksplodimi. Përbajtet mund të shpërthejnë kur të ngrohen.</p>	<p>Strehohu. Qëndro larg nga zonat e ulëta. Parandalo materialet që rrjedhin nga futja në mjedise ujore apo sistemet e kanalizimit.</p>
<p>Materialet e ndezshme të ngurta, substancat vetë-reaktive dhe eksplozivet e ngurta të pandezshme</p> <p>4.1</p> 	<p>Rrezik nga ndezja. Të djegshme apo të ndezshme, mund të ndizet nga nxehtësia, shkëndijat apo flakët. Mund të përmban materiale vetë-reaktive që u nënshtrohen dekompozimit ekzotermikë në rast të furnizimit me nxehtësi, kontaktit me materialet tjera (të tilla si acidet, komponentët e metalit të rëndë ose aminet), friksionit apo tronditjes. Kjo mund të rezultojë në evoluimin e gazrave apo avujve të dëmshme dhe të ndezshme. Përbajtet mund të shpërthejnë kur të ngrohen.</p>	<p>Parandalo materialet që rrjedhin nga futja në mjedise ujore apo sistemet e kanalizimit.</p>

Shënim 1: Për mallrat e rrezikshme me rreziqe të shumfishta dhe për ngarkesat e përziera, secila e hyrje e aplikueshme do të mbikëqyret.

Shënim 2: Udhëzimet shtesë të paraqitura më lartë mund të përshtaten për reflektim të klasave të mallrave të rrezikshme që transportohen dhe mjetin e tyre të transportit.

Etiketat dhe shenjat e rrezikshme	Karakteristikat e rrezikut	Udhëzimet shitesë
(1)	(2)	(3)
4.2 Substancat që mund të vetëndizen 	Rrezik nga ndezja spontane nëse paketat dëmtohen apo përbajtet derdhen. Mund të reagon fuqishëm me ujin.	
4.3 Substancat që në kontakt me ujin krijojnë gazra të ndezshëm 	Rrezik nga ndezja dhe eksplodimi në kontakt me ujin.	Materiet e derdhura duhet të ruhen në të thatë duke mbuluar derdhjet.
5.1 Substancat Osiduese 	Rrezik nga marrja flakë dhe eksplodimi. Rrezik nga reagimi i fuqishëm në kontakt me materiet e ndezshme.	Shmang përzjerjen me materiet e djegshme apo të ndezshme (p.sh. tallashi).
5.2 Peroksidet organike 	Rrezik nga dekompozimi ekzotermik në temperatura të ngritura në kontakt me materiet tjera (të tilla si acidet, komponentët e metalit të rëndë ose aminet), friksionit apo tronditjes. Kjo mund të rezultojë në evoluimin e gazrave apo avujve të dëmshme dhe të ndezshme.	Shmang përzjerjen me materiet e djegshme apo të ndezshme (p.sh. tallashi).
6.1 Substancat toksike 	Rrezik nga helmimi. Rrezik për mjedisin ujor dhe sistemin e kanalizimit.	Përdor maskën emergjente e shpëtimit.
6.2 Substancat infektuese 	Rrezik nga infektimi. Rrezik për mjedisin ujor dhe sistemin e kanalizimit.	
7A 7B 7C 7D Materiet radioaktive 	Rrezik prej rrezatimit të brendshëm dhe të jashtëm.	Koha e limituar ndaj ekspozimit.
7E Materiet e zbrërthyeshme (zinxhiror) 	Rrezik nga reagimi nuklear zinxhiror.	
8 Substancat korrozive 	Rrezik nga djegiet. Mund të reagon fuqishëm me njëra tjetrën, me ujë dhe me materiet tjera. Rrezik për mjedisin ujor dhe sistemin e kanalizimit.	Parandalo materiet që rrjedhin nga futja në mjediset ujore apo sistemet e kanalizimit.
9 Substancat dhe artikujt tjer të rrezikshme 	Rrezik nga djegiet. Rrezik nga ndezja. Rrezik nga eksplodimi. Rrezik për mjedisin ujor dhe sistemin e kanalizimit.	Parandalo materiet që rrjedhin nga futja në mjediset ujore apo sistemet e kanalizimit.

Pajisjet për mbrojtje personale dhe të përgjithshme për të kryer veprimet të përgjithshme dhe veprimeve emergjente specifike të rrezikshme për bartje në automjet në pajtim me seksionin 8.1.5 të ADR-it

Pajisjet në vijim do të barten brenda njësisë së transportit për të gjithë numrat e etiketuar të rrezikut:

- për secilin automjet, pengesën (bllokadën) e rrotave të madhësisë së përshtatshme me masën maksimale të automjetit dhe me diametër të rrotës;
- dy shenja paralajmërimi vertikale;
- lëngë për shpëlarje të syve^a; dhe

Për secilin anëtarë të ekuipazhit të automjetit:

- jelekun paralajmërues (p.sh. si përshkruhet në standardin EN 471);
- aparat lëvizës për ndriçim;
- një palë dorëzash mbrojtëse; dhe
- mbrojtëse të syve (p.sh. syza mbrojtëse).

Pajisjet shitesë të nevojshme për klasa të caktuara:

- maskë shpëtimi emergjente^b për secilin anëtarë të ekuipazhit të automjetit do të bartet brenda në automjet për numrat e etiketuar të rrezikut 2.3 dhe 6.1;
- lopatë^c;
- vulë drenazhimi^c;
- kontejner mbledhës i prodhuar nga plastika^c.

a Nuk nevojitet për numrat e etiketimit të rrezikut 1, 1.4, 1.5, 1.6, 2.1, 2.2 dhe 2.3.

b Për shembull një maskë shpëtimi në rast emergjence me filtrin e kombinuar për gazra/pluhur të tipit A1B1E1K1-P1 ose A2B2E2K2-P2 e cila është e ngjashme me atë të përshkruar në standardin EN 141.

c Nevojitet vetëm për numrat e etiketimit të rrezikut 3, 4.1, 4.3, 8 dhe 9.

**International Road Transport
Union, Secretariat General**

Tel: +41-22-918 27 00

Fax: +41-22-918 27 41

E-mail: iru@iru.org

Web: www.iru.org